20. 10. 2026

Në mbështetje të nenit 4, paragrafit 3, nën paragrafëve 3.2 dhe 3.6, nenit 19, paragrafit 3, dhe nenit 47, paragrafit 3, të Ligjit Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, si dhe në përputhje me nenin 14, 24 dhe nenin 27 të Rregullores Nr. 17/2026 për Përcaktimin e Tarifave për Shërbimet e Ujit në Kosovë, Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit merr këtë:

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-
REPUBLIC OF KOSOVO
Regulatorni Autoritet za Usluge Vode
Water Services Regulatory Authority
Njësia/Jedinica/Unit
Nr. shkres./Upis. Br./Req. No. 716
Data/Datum/Date 20/10/2026
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

VENDIM

për miratimin e urdhëresës së tarifave të shërbimeve (UTSH)

1. Miratohet Urdhëresa Tarifore e Shërbimeve (UTSH) e KRU "Hidrodrini" sh. a (ARRU/UTSH-19/03/2027), për aktivitetet themelore të shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura.
2. Lartësia e tarifave përfshinë vetëm vlerën faturale (përjashtohet TVSH), për shërbimet themelore.
3. Monitorohet për së afërmi realizimi i investimeve kapitale të aprovuara nga ARRU, dhe do të ndërmerren veprime komfor Nenit 7 pika 4 të Rregullores 17/2026 për Përcaktimin e Tarifave për Shërbimet e Ujit në Kosovë.
4. ARRU mund të bëjë korrigjime të jashtëzakonshme të UTSH, me kërkesë të ofruesit të shërbimeve në përputhje me nenin 47 të *Ligjit Nr. 05/L-042, për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit dhe* në pajtim me nenin 25 të Rregullores 17/2026 Për Përcaktimin e Tarifave të Shërbimit të Ujit në Kosovë.
5. Ofruesi i shërbimeve duhet të shpërndajë Listën e Tarifave të Shërbimit të aprovuara me këtë UTSH, tek secili Konsumator, në momentin e nënshkrimit të Kontratës për Shërbime ose së paku një herë në fillim të aplikimit të saj t'i bashkëngjis të njëjtën, faturës të konsumatorëve.
6. Lista e Tarifave për Shërbime, e aprovuar nga ARRU me këtë UTSH, duhet të publikohet nga ofruesi i shërbimeve së paku në njërën prej gazetave ditore me tirazh gjithë përfshirës në tërë Kosovën, brenda shtatë (7) ditëve të punës, pas shpalljes dhe publikimit të saj nga ARRU ueb faqen: www.arru-rks.org;
7. Kjo UTSH publikohet në tre (3) gjuhë, dy nga të cilat janë zyrtare në Kosovë dhe në Gjuhën Angleze. Në rast mospërputhje në mes të versioneve (për gjuhët e përdorura) të UTSH-ës, do të mbizotërojë versioni i shkruar në Gjuhën Shqipe.
8. UTSH, hyn në fuqi më 1 janar 2027 dhe se vlen vetëm për vitin fiskal 2027 (01.01-31.12.2027).

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pa këndqur ka të drejtë ankese në Komisionin Shqyrtues, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi me shkrim.*

Dërguar:
1 x 1 Arkivit të ARRU
1 x 1 Departamenti i Tarifave
1 x 1 Krye shefit Ekzekutiv të KRU-së

Abedin Azizi
Zëvendësdrejtori i ARRU

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY

ARRU

URDHËRESË TARIFORE NR. 19/03/2027

PËR SHËRBIMET E UJIT TË KRU "HIDRODRINI" SH.A. PËR VITIN 2027

Në mbështetje të nenit 4, paragrafit 3, nën paragrafëve 3.2 dhe 3.6, nenit 19, paragrafit 3, dhe nenit 47, paragrafit 3, të Ligjit Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, si dhe në përputhje me nenin 11, 24 dhe nenin 27 të Rregullores Nr. 17/2026 për Përcaktimin e Tarifave për Shërbimet e Ujit në Kosovë, Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit nxjerr këtë urdhëresë tarifore:

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj Urdhërese është përcaktimi i strukturës dhe lartësisë së tarifave të miratuara nga ARRU për shërbimet e ujësjellësit dhe të ujërave të ndotura që ofrohen nga ofruesi i shërbimeve.për vitin tarifor 2027, si dhe sigurimi i zbatimit të tyre në mënyrë të drejtë, transparente dhe jo diskriminuese.

Neni 2
Fushëveprimi

Kjo Urdhëresë zbatohet nga KRU "Hidrodrini" Sh.A. për të gjitha shërbimet dhe kategoritë e konsumatorëve për të cilat janë përcaktuar tarifat me këtë Urdhëresë, brenda zonës së shërbimit të përcaktuar me licencën e saj.

Neni 3
Kategoritë e konsumatorëve

1. Për qëllime të zbatimit të tarifave të përcaktuara me këtë Urdhëresë, konsumatorët klasifikohen në këto kategori:
   1.1. Konsumatorë shtëpiakë;
   1.2. Konsumatorë komercialë/industrialë; dhe
   1.3. Konsumatorë institucionalë.

Neni 4
Tarifat volumetrike

1. Tarifa volumetrike aplikohet mbi bazën e vëllimit të ujit të konsumuar dhe, sipas rastit, vëllimit të ujërave të ndotura të shkarkuara.
2. Tarifat volumetrike për shërbimet e ujësjellësit dhe ujërave të ndotura janë:

Kategoria e Konsumatorëve	Njësia	Tarifa volumetrike për shërbimet e ujësjellësit	Tarifa volumetrike për shërbimet e ujërave të ndotura
Shtëpiak	EUR/m^3	0.4160	0.1622
Jo-shtëpiak (komercial dhe Institucional)	EUR/m^3	0.4992	0.3083

3. Tarifat nga paragrafi 2 i këtij neni aplikohen për çdo metër kub të faturuar, në përputhje me rregullat për matjen, faturimin dhe përcaktimin e konsumit të përcaktuara me aktet në fuqi.

Neni 5
Tarifa fikse mujore

1. Tarifa fikse mujore aplikohet për çdo konsumator të lidhur në rrjetin e ofruesit të shërbimeve dhe përcaktohet sipas diametrit të gypit të kyçjes në rrjetin shpërndarës.
2. Tarifa fikse mujore aplikohet pavarësisht nga sasia e ujit të konsumuar dhe faturohet çdo muaj.
3. Tarifa fikse mujore për ofruesin e shërbimeve është:

Diametri i kyçjes në rrjetin shpërndarës	Njësia	Vlera
Konsumatorët vetëm me lidhje të ujërave të ndotur	EUR/kons/muaj	0.6915
15mm	EUR/kons/muaj	1.3830
20mm	EUR/kons/muaj	1.3830
25mm	EUR/kons/muaj	2.2127
32mm	EUR/kons/muaj	2.2127
40mm	EUR/kons/muaj	8.9615
50mm	EUR/kons/muaj	8.9615
65mm	EUR/kons/muaj	22.1272
80mm	EUR/kons/muaj	22.1272
100mm	EUR/kons/muaj	27.2165
125mm	EUR/kons/muaj	27.2165
150mm	EUR/kons/muaj	42.9268
200mm	EUR/kons/muaj	42.9268
250mm	EUR/kons/muaj	59.7435

4. Për konsumatorët me diametër të kyçjes që nuk është i përcaktuar në tabelën e paragrafit 3 të këtij neni, ofruesi i shërbimeve nuk mund të aplikojë tarifë tjetër pa miratim paraprak të Autoritetit.

Neni 6
Tarifat për inspektimin dhe pranimin teknik të lidhjeve të reja

1. Tarifa për inspektimin e lokacionit për lidhje të re dhe pranimin teknik të lidhjes është 10.00 EUR për konsumator, pavarësisht nga diametri i gypit të lidhjes.
2. Tarifa nga paragrafi 1 e këtij neni aplikohet një herë për kërkesën për lidhje dhe përfshin:

    2.1. inspektimin e lokacionit;
    2.2. përcaktimin e lokacionit të lidhjes; dhe
    2.3. pranimin teknik të lidhjes.

3. Kur kërkesa përfshin njëkohësisht lidhjen në rrjetin e ujësjellësit dhe në rrjetin e kanalizimit, tarifa nga paragrafi 1 paguhet vetëm një herë për konsumator.

Neni 7
Tarifat për realizimin fizik të lidhjes së re në rrjetin e ujësjellësit

1. Tarifat për realizimin fizik të lidhjes së re në rrjetin e ujësjellësit janë:

Kategoria e Konsumatorëve	Diametri i gypit të lidhjes	Tarifa e lidhjes (pa pusetë) (EUR)
Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak (komercial dhe Institucional)	15 mm	80.00
	20 mm	80.00
	25 mm	100.00
	32 mm	140.00
	40 mm	180.00
	50 mm	370.00
	65 & 75 mm	490.00
	80 mm	625.00
	100 mm	780.00

2. Tarifat e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni aplikohen për realizimin fizik të lidhjes në rrjetin e ujësjellësit, pa përfshirë ndërtimin e pusetës dhe punimet e asfaltimit.
3. Në rastet kur konsumatori kërkon që ndërtimi i pusetës për vendosjen e ujëmatësit të realizohet nga ofruesi i shërbimeve, shpenzimet përcaktohen në bazë të vëllimit të punimeve, kushteve teknike në terren dhe çmimeve të tregut. Para fillimit të punimeve, ofruesi i shërbimeve është e obliguar t'i paraqesë konsumatorit paramasën dhe parallogarinë e detajuar të punimeve dhe kostove përkatëse. Faturimi bëhet vetëm për punimet e realizuara, në bazë të shpenzimeve të dokumentuara dhe të arsyetuara.

Neni 8
Tarifat për realizimin fizik të lidhjes së re në rrjetin e kanalizimit

1. Tarifat për realizimin fizik të lidhjes së re në rrjetin e kanalizimit janë:

Kategoria e Konsumatorëve	Diametri i gypit të lidhjes	Tarifa e lidhjes (pa pusetë) (EUR)
Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak (komercial dhe Institucional)	160 mm	26.00
	200 mm	36.00
	250 mm	46.00
	315 mm	76.00

2. Dispozitat e nenit 7, paragrafët 2 dhe 3, të kësaj Urdhërese zbatohen përshtatshmërish edhe për lidhjet e reja në rrjetin e kanalizimit.

Neni 9
Tarifat për ndërprerjen dhe rilidhjen e shërbimeve

1. Tarifa për ndërprerjen dhe rilidhje janë:

Kategoria	Diametri i gypit	Tarifa (EUR)
Ndërprerja e përkohshme e lidhjes	Për të gjitha dimensionet e gypave shpërndarës	10
Ndërprerjen e përhershme e lidhjes	Për të gjitha dimensionet e gypave shpërndarës	20
Rilidhja në shërbime	Për të gjitha dimensionet e gypave shpërndarës	10

2. Tarifat e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni aplikohen në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në Rregulloren Nr. 18/2026 për Ndërprerje dhe Rilidhje të Shërbimeve të Ujit në Kosovë.

Neni 10
Verifikimi dhe kalibrimi i ujëmatësve

Tarifat për verifikimin e ujëmatësve dhe shërbimet përkatëse metrologjike që lidhen me saktësinë e matjes së ujit zbatohen sipas Udhëzimit Administrativ (MINT) Nr. 06/2022 për Lartësinë dhe Procedurën e Pagesës për Shërbimet në Metrologji, përkatësisht Shtojcës I, që rregullon tarifat për verifikimin e ujëmatësve, si dhe akteve të tjera përkatëse në fuqi. Verifikimi i saktësisë së ujëmatësve mund të kryhet edhe nga subjekte të tjera të akredituara nga autoriteti kompetent, në përputhje me legjislacionin në fuqi për metrologjinë dhe brenda fushëveprimit të autorizimit ose licencës përkatëse.

Neni 11
Tarifa e mbingarkesës

1. Tarifa e mbingarkesës, përkatësisht tarifa për përforcimin e infrastrukturës, zbatohet në përputhje me nenin 12 dhe nenin 31 të Rregullores Nr. 17/2026 për Përcaktimin e Tarifave për Shërbimet e Ujit në Kosovë.
2. Tarifa e mbingarkesës fillon të aplikohet nga 1 janari 2027, në përputhje me kushtet, procedurat dhe metodologjinë e përcaktuar nga Autoriteti.
3. Çdo faturim i tarifës së mbingarkesës përpara datës 1 janar 2027 është i ndaluar.
4. Tarifat e mbingarkesës për konsumatorët e rinj, janë:

Nr.	Diametri (mm)	Ujësjellës pa TVSH	Kanalizim pa TVSH	Totali pa TVSH
1	15	37.71	7.31	45.02
2	20	37.71	7.31	45.02
3	25	37.71	7.31	45.02
4	32	39.86	7.73	47.58
5	40	62.28	12.07	74.35
6	50	97.31	18.86	116.17
7	65	164.45	31.88	196.33
8	80	249.11	48.29	297.40
9	100	389.23	75.45	464.69
10	125	608.18	117.90	726.07
11	150	875.78	169.77	1,045.55
12	200	1,138.51	220.70	1,359.21
13	250	1,480.06	286.91	1,766.97

Neni 12
Zbatimi i tarifave dhe faturimi

1. Ofruesi i shërbimeve është përgjegjëse për zbatimin e saktë, të plotë dhe jo diskriminues të tarifave të përcaktuara me këtë Urdhëresë.
2. Tarifat duhet të pasqyrohen qartë në faturat e konsumatorëve, duke mundësuar identifikimin e shërbimit, njësisë së matjes, sasisë së faturuar, tarifës së aplikuar dhe shumës përkatëse.
3. Ofruesi i shërbimeve nuk mund të ndryshojë vlerat e tarifave të përcaktuara me këtë Urdhëresë pa vendim ose miratim të Autoritetit, sipas procedurave të përcaktuara me legjislacionin dhe aktet rregullatore në fuqi.
4. Në rast të mospërputhjes ndërmjet tarifave të publikuara nga ofruesi i shërbimeve dhe tarifave të përcaktuara me këtë Urdhëresë, zbatohen tarifat e përcaktuara nga Autoriteti.
5. Të gjitha tarifat e përcaktuara në këtë UTSH janë pa Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH).

Neni 13
Informimi dhe publikimi

1. Ofruesi i shërbimeve është e obliguar të publikojë këtë Urdhëresë dhe tarifat e miratuara në faqen e saj zyrtare.
2. Tarifat dhe kushtet e aplikimit të tyre duhet të jenë të qasshme për të gjithë konsumatorët në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme.
3. Publikimi dhe informimi i konsumatorëve bëhet në përputhje me kërkesat e Rregullores Nr. 17/2026 dhe aktet tjera relevante të Autoritetit.

Neni 14
Ankesat

Ankesat e konsumatorëve lidhur me zbatimin e tarifave të përcaktuara me këtë Urdhëresë paraqiten dhe shqyrtohen në përputhje me procedurat e përcaktuara me legjislacionin dhe aktet rregullatore në fuqi për trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve.

Neni 15
Mbikëqyrja e zbatimit

1. Zbatimin e kësaj Urdhërese nga ofruesi i shërbimeve e mbikëqyr Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, në përputhje me kompetencat e tij ligjore dhe rregullatore.
2. Ofruesi i shërbimeve është e obliguar t'i ofrojë Autoritetit të gjitha të dhënat, dokumentet dhe informacionet e nevojshme për verifikimin e zbatimit të tarifave.
3. Në rast të konstatimit të shkeljeve, Autoriteti mund të ndërmarrë masat e parashikuara me legjislacionin dhe aktet rregullatore në fuqi.

Neni 16
Dispozitat kalimtare

1. Kërkesat për shërbime të paraqitura para datës 1 janar 2027 trajtohen sipas tarifave të zbatueshme në kohën e kryerjes së shërbimit, duke respektuar aktet përkatëse dhe pa cenuar të drejtat e fituara të konsumatorëve.
2. Ofruesi i shërbimeve është e obliguar që sistemet e faturimit, dokumentet e brendshme, tariforet, njoftimet dhe materialet për konsumatorët t'i harmonizojë me këtë Urdhëresë.

Neni 17
Shfuqizimi

Nga data 1 janar 2027 pushojnë së zbatuari tarifat e miratuara për vitin 2026 për ofruesin e shërbimeve, për shërbimet që mbulohen nga kjo Urdhëresë, pa cenuar detyrimet e krijuara ligjërisht gjatë vitit 2026.

Neni 18
Hyrja në fuqi

Kjo Urdhëresë hyn në fuqi dhe fillon të zbatohet më 1 janar 2027.

Datë 20/10/2026

Zëvendësdrejtori i ARRU

Abedin Azizi